



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10 Shkurt 2022

Nr: 55

V E N D I M

PËR

**VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË
KANDIDATIT PËR KRYETAR NË BASHKINË DIBËR, Z. RAHIM PETRIT SPAHIU NË
ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË
PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13 438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 67, pika 2, nenit 72, nenit 73, nenit 165, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 5, pika 4, shkronja “a” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” si dhe të vendimi nr. 2, datë 22.1.2022 “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e depozituar për regjistrim e kandidatit për kryetar bashkie për zgjedhjet e pjesshme vendore që do të zhvillohen në datën 6 Mars 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



Data: 10 Shkurt 2022

Nr. 55

“Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në bashkinë Dibër, z. Rahim Petrit Spahiu, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V Ë R E N:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13 438, datë 20.01.2022, ka caktuar datën 6 Mars 2022, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për Bashkinë Shkodër, Bashkinë Dibër, Bashkinë Durrës, Bashkinë Vorë, Bashkinë Rrogozhinë dhe Bashkinë Lushnjë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 32, datë 2.2.2022, “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë Socialiste të Shqipërisë për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”, ka regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me kryetar z. Edi Rama.

Në zbatim të nenit 67, pika 1, neneve 72 dhe 165, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, “Partia Socialiste e Shqipërisë” ka depozituar në KZAZ, kërkesën për regjistrimin e z. Rahim Petrit Spahiu, si kandidat për kryetar në bashkinë Dibër.

Z. Rahim Petrit Spahiu, në përputhje me parashikimet e nenit 5, pika 4, shkronja “a” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i kryetarit të bashkisë.

Nga verifikimi prima facie i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në bashkinë Dibër, Qarku Dibër, z. Rahim Petrit Spahiu rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit, nr. 138/2015 dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja “b” dhe paragrafi 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, me shkresën nr. 677 prot., datë 10.02.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 676 prot., datë 10.02.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për kryetar bashkie në bashkinë Dibër, Qarku Dibër, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për kryetar në bashkinë Dibër, Qarku Dibër, z. Rahim Petrit Spahiu.



Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 1490/1 prot., datë 10.02.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për kryetar në bashkinë Dibër, Qarku Dibër, z. Rahim Petrit Spahiu, i cili rezulton se nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë, është i padënuar.

Referuar ligjit, nr. 138/2015 dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për kryetar në bashkinë Dibër, Qarku Dibër, z. Rahim Petrit Spahiu, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

Referuar nenit 33, shkronja “f” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga 1 (një) KZAZ.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, i ndryshuar, KZAZ duhet të vazhdojnë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Dibër, Qarku Dibër, të propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë” për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 67, pika 2, nenin 72, nenin 73, nenin 165, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, nenin 5, pika 4, shkronja “a” e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” si dhe të vendimi nr. 2, datë 22.1.2022 “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”



Data: 10 Shkurt 2022
Nr. 55

“Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në bashkinë Dibër, z. Rahim Petrit Spahiu, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S I :

1. Kandidati për kryetar bashkie, z. Rahim Petrit Spahiu, propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar të bashkisë Dibër, të datës 6 Mars 2022, nuk është në kushtet e moskandidimit.
2. KZAZ nr. 19, të vijojë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, z. Rahim Petrit Spahiu, propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 10 Shkurt 2022
Nr. 55

“Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në bashkinë Dibër, z. Rahim Petrit Spahiu, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”